

MENAXHIMI I INTEGRUAR I RESURSEVE UJORE NË KOSOVË (IWRM-K)

Faza 1
Maj 2020 – Prill 2024

LETËR MARRËVESHJE

Ndërmjet

Programi Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë dhe
Bashkëpunimi Akademik udhëhequr nga Universiteti i Prishtinës
'Hasan Prishtina'

për zbatimin e
Programit Master në Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore

Tetor 2021

Letër Marrëveshje ndërmjet

Programi Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë dhe
Bashkëpunimi Akademik udhëhequr nga Universiteti i Prishtinës 'Hasan
Prishtina'

Të quajtuara bashkarisht si 'Palët',

DUKE MARRË PARASYSH QË, Programi zviceran 'Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë' (referuar tutje si IWRM-K, apo Programi), i cili zbatohet nga Skat Consulting Ltd., St. Gallen, si dhe Agjencia e Mjedisit të Austrisë (EAA), të përfaqësuara ligjërisht në Kosovë nga dega e Skat Consulting me seli në Prishtinë, **dëshiron të krijoj partneritet me Bashkëpunimin Akademik të udhëhequr nga Universiteti i Prishtinës 'Hasan Prishtina', Kosovë** (referuar tutje si AP-UPHP) për **zbatimin e Programit Master në Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë** (referuar tutje si MP-IWRM) sipas kushteve të paraqitura në këtë Letër Marrëveshje, përfshirë Thirrjen për Shprehje Interesi dhe Aplikacionin

Programi IWRM-K financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatohet nga Skat Consulting Ltd. (Zvicër) në konsorcium me Agjencinë e Mjedisit të Austri (EAA)



korrespondues të bashkangjitur në Shtojcën 2;

DUKE MARRË PARASYSH QË, AP-UPHP janë të gatshëm të hyjnë në partneritet veçanërisht në përgatitjen, organizimin dhe implementimin e aktiviteteve, që synojnë përmirësimin e zhvillimit të njohurive dhe shkathtësive të profesionistëve në menaxhim të resurseve ujore në Kosovë;

DUKE MARRË PARASYSH QË, Palët dëshirojnë t'i përcaktojnë kushtet e një partneriteti të tillë; PRANDAJ, Palët pajtohen që t'i pranojnë kushtet e përcaktuara të këtij partneriteti.

1. Rreth Programit IWRM-K

Programi i Menaxhimit të Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë i financuar nga Zvicra (IWRM-K) synon të zhvillojë kapacitete afatgjata për administrimin e resurseve ujore në nivel kombëtar dhe të pellgjeve lumore në përputhje me prioritetet socio-ekonomike dhe politike të Kosovës, si dhe me nevojat e zhvillimit të qëndrueshëm në të ardhmen. Ai synon që të ndihmojë në zëvendësimin e qasjes aktuale të fragmentuar me një qasje më gjithëpërfshirëse dhe me pjesëmarrje më të gjerë në menaxhimin e resurseve ujore në nivel të pellgjeve lumore, të harmonizuar me parimet e Menaxhimit të Integruar të Resurseve Ujore (MIRU) dhe Direktivës së Kornizës Ujore të Bashkimit Evropian.

Në përputhje me këto orientime strategjike, Programi IWRM-K është dizajnuar të ndihmojë në adaptimin e sistemit kombëtar gjithëpërfshirës të MIRU-së, duke e kombinuar zhvillimin institucional dhe të kapaciteteve (teknike) të inkuorpuara në një gamë masash të ndërlidhura me njëra-tjetrën.

Një pjesë e konsiderueshme e intervenimeve programore lidhet me ngritjen e kapaciteteve, duke përfshirë zhvillimin e arsimit/njohurive dhe shkathtësive të profesionistëve të ujit. Në mënyrë të veçantë, Programi ka për qëllim të mbështesë administratën shtetërore (ujërat), profesionistët e rinj (të ujit), qarqet akademike dhe hulumtuese, OSHC/OJQ, si dhe palët e tjera të interesit. Një nga aktivitetet e rëndësishme arsimore të mbështetura nga Programi është zhvillimi i një MP-IWRM ndërdisiplinor që është identifikuar si prioritet gjatë një pjese të një procesi të mëparshëm vlerësimi të mbështetur nga Programi. Përfundimisht, MP-IWRM synon të sjellë njohuri ndër-disiplinore tek profesionistët me arsimim (p.sh. inxhinieri, ekonomi, ekologji, shkencë mjedisore, shkencë sociale) dhe përvojë të ndryshme, që janë edhe grupi i synuar. Ky program master do të jetë i dobishëm në përmirësimin e dialogut dhe tejkalimin e boshllëqeve midis profesioneve të ndryshme që merren me aspekte të ndryshme të menaxhimit të resurseve ujore dhe do të sjellë së bashku dimensione të ndryshme që ende konsiderohen jokonvencionale për praktikatat dhe traditat e menaxhimit të resurseve ujore në rajon (p.sh. aspektet sociale, gjinore, politike, mjedisore). Në një mënyrë të tillë, profesionistët e ardhshëm (të ujit) do të pajisen shumë më mirë me njohuri dhe aftësi bashkëkohore për të menaxhuar sfidat dhe pasiguritë e menaxhimit të resurseve ujore të jetës reale.

2. Rreth AP-UPHP

MP-IWRM do të udhëheqet nga Universiteti i Prishtinës 'Hasan Prishtina', Prishtinë, në partneritet me Universitetin 'Haxhi Zeka' (UHZ), Pejë, dhe me institucionet akademike ndërkombëtare të tjera¹.

Universiteti i Prishtinës 'Hasan Prishtina' (UPHP) përfaqësohet nga Fakulteti i Ndërtimitarisë/Departamenti i Hidroteknikës, në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore/Departamenti i Biologjisë. Ndërsa, Universiteti 'Haxhi Zeka' (UHZ) do të përfaqësohet nga Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis.

¹ Do të përcaktohen më vonë nga IWRM-K dhe AP-UPHP, me anë të një marrëveshjeje të bashkëpunimit.

Stafi dhe studentët e të dy universiteteve, fakulteteteve përkatëse angazhohen në hulumtime të ndryshme duke shfaqur kreativitetin e tyre në një sërë disiplinash siç janë: shkencat natyrore dhe teknike, artet, shkencat humane, shkencat shoqërore, ekonomia dhe biznesi, shkencat juridike dhe ato të bujqësisë. Ambientet e tyre studimore inkurajojnë hulumtimin dhe shkëmbimin ndërdisiplinorë të ideve dhe programeve të reja.

UPHP është një institucion publik i arsimit të lartë, i cili organizon dhe zhvillon programe studimore universitare, punime të avancuara shkencore dhe profesionale. Fakulteti i Ndërtimtarisë është një njësi akademike e UPHP me një histori të gjatë duke filluar që nga viti 1961. Prandaj, Fakulteti i Ndërtimtarisë është fakulteti me përvojën më të gjatë në arsimin e lartë në Kosovë, i cili ka një grup të madh të profesorëve në dispozicion, gjithsej 29 profesorë dhe 15 asistentë. Departamenti Hidroteknik ka organizuar studimet e para të programit të masterit për Menaxhimin e Ujit dhe Mjedisit në vitin 2001, i cili u zhvillua dhe u implementua me mbështetjen e Qeverisë së Finlandës, me ligjërata të ofruara kryesisht nga profesorët nga 'Universiteti Tampere' (Finlandë). Që nga viti 2001, ky departament ka dëshmuar vazhdimisht qëndrueshmëri në organizimin dhe ofrimin e studimeve master. Përveç kësaj, ka demonstruar edhe gatishmërinë për të bashkëpunuar dhe për të u përfshirë në programet e financuara dhe implementuara nga partnerët/donorët ndërkombëtarë, duke ofruar ekspertizën e tyre teknike për të mbështetur institucionet e Kosovës, p.sh. Programi Mbështetja e Mjedisit në të Ardhmen, Plani Strategjik i Ujërave në Kosovë, si dhe bashkëpunime tjera me universitetet në nivel rajonal/ndërkombëtar.

Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore është njësi e 'Universitetit të Prishtinës'. Është themeluar në vitin 1971 dhe ka pesë departamente: Kimi, Biologji, Fizikë, Gjeografi dhe Matematikë. Ky fakultet ofron programe studimi në nivelin Baçelor, Master dhe Doktoratë. Departamenti i Biologjisë në aspektin akademik ka gjithsej 25 punonjës, 17 prej tyre profesorë (9 profesorë të rregullt, 6 profesorë të asociuar dhe 2 profesorë asistentë), si dhe 8 asistentë ligjërues.

Universiteti 'Haxhi Zeka' dhe Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis është një pasardhës i Departamentit të Menaxhimit, Turizmit dhe Hotelierisë (1969-1975) që ishte pjesë e Shkollës së Lartë Ekonomike, e themeluar në vitin 1969 si një institucion i arsimit të lartë. Në vitin akademik 2001/2002 Shkolla e Lartë Ekonomike u reformua sipas modelit të Deklaratës së Bolonjës dhe në të njëjtin vit, Senati i Univerisitetit të Prishtinës miratoi kurrikulat për diplomën e nivelit baçelor sipas kësaj deklaratë. Fakulteti synon të luajë një rol drejtues në zhvillimin e arsimit në lidhje me reformimin e menaxhimit të turizmit, mbrojtjes së mjedisit, zhvillimin e produkteve vendore turistike, menaxhimin e projekteve strategjike për zhvillimit të

turizmit, trajnimin profesional dhe shkencor në menaxhimin dhe zhvillimin e secilit produkt, menaxhimin e turizmit dhe hotelierisë, si dhe menaxhimin e mjedisit brenda dhe jashtë vendit.

Prandaj, Palët pajtohen si në vijim:

Neni 1: Kushtet e përgjithshme

1. Në përputhje me dokumentet e bashkëngjitura në Shtojcën 2 dhe Termat e Referencës dhe buxhetit (Shtojca1), të dakorduara gjatë procesit të bisedimeve, IWRM-K konfirmon pranimin e aktiviteteve që do të ofrohen nga AP-UPHP drejt implementimit të MP-IWRM.
2. AP-UPHP do të jetë plotësisht përgjegjës në kryerjen e të gjitha aktiviteteve e bashkëngjitura në Shtojcën 2 me përkushtim dhe efikasitet, si dhe në përputhje me politikat, rregulloret, e direktivat e tjera, deri në atë masë që të jenë konsistente me rregullat dhe rregulloret e IWRMK. Në raste të tjera, politikat e IWRM-K duhet të ndiqen.

3. Për kryerjen e aktiviteteve sipas kësaj Letër Marrëveshjeje, personeli dhe nënkontraktorët e AP-UPHP nuk konsiderohen në asnjë aspekt si punonjës ose përfaqësues të IWRM-K dhe AP-UPHP.
4. IWRM-K nuk pranon asnjë përgjegjësi për pretendimet që rrjedhin nga veprimet ose mosveprimet e AP-UPHP apo personelit të tij, kontraktorëve apo personelit të tyre përkatës, gjatë kryerjes së aktiviteteve sipas kushteve të kësaj Letër Marrëveshjeje , apo çfarëdo pretendimi për rastet potenciale të vdekjes, lëndimeve trupore, aftësive të kufizuara, dëmtimit të pronës, apo rreziqeve të tjera që mund t'i pësojë AP-UPHP dhe personeli i tij, si rezultat i punës së tyre në lidhje me kryerjen e aktiviteteve sipas kësaj Letër Marrëveshjeje.

Gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje, IWRM-K dhe AP-UPHP, do të specifikojnë kushtet e bashkëpunimit me përfshirjen e universiteteve ndërkombëtare të besueshme , por që nuk kufizohen në vizita studimore, shkëmbimin e përvojave (duke përfshirë ngritjen e programit mësimor), punë kërkimore dhe bursa. Çdo mundësi e cila është në interesin e përbashkët të palëve nënshkruese të Letër Marrëveshjes, do të ndiqet në pajtim me objektivat e IWRM-K dhe buxhetin përkatës në dispozicion.

Neni 2: Konsultimet, shkëmbimi i informacionit dhe vizibiliteti

1. Palët do të bëjnë përpjekjet për ta mbajtur njëri-tjetrin të informuar dhe konsultuar për çështje me interes të përbashkët, të cilat sipas mendimit të tyre mund ta rrisin bashkëpunimin e ndërsjellë.
2. Përsonat (e përcaktuar) kontaktues të Palëve do të takohen rregullisht për të rishikuar progresin si dhe për të planifikuar aktivitetet e ardhshme.
3. Palët do ta informojnë menjëherë njëra-tjetrën, për çdo rrethanë që mund të ndërhyjë ose mund të kërcënojë ecurinë e zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta.
4. Për çdo çështje që nuk mbulohet në mënyrë specifike nga kjo Letër Marrëveshjeje, Palët do të sigurojnë që ato çështje të zgjidhen në përputhje me dispozitat përkatëse të politikave, rregullave dhe rregulloreve të AP-UPHP dhe IWRM-K.
5. Asnjëra nga Palët nuk do ta përdorë emrin ose logon e palës tjetër, apo ndonjë shkurtesë, lidhur me aktivitetet, pa miratimin paraprak me shkrim të palës tjetër, për secilin rast.

E gjithë korrespondenca, kërkesat, urdhërat, si dhe komunikimet e tjera do të konsiderohen të vlefshme, për derisa ato transmetohen me anë të letrave, postës, e-mailit, ose me ndonjë mënyrë tjetër, në formë të shkruar, drejtuar personave përgjegjës si në vijim:

Për AP-UPHP

Emri i plotë: Prof. Asoc. Dr. Laura Kusari

Pozita: Mësimdhënëse dhe Koordinatore e MP-IWRM

Email: laura.kusari@uni-pr.edu

Numri kontaktues (celulari): +383 44 122 163

Për IWRM-K

Emri i plotë: Vera Muhaxhiri

Pozita: Zëvendës-Udhëheqëse e Ekipit dhe Koordinatore e MP-IWRM Email:

vera.muhaxhiri@int.skat.ch

Numri kontaktues (celulari): +383 44 299 635

Neni 3: Prokurimi dhe mënyrat e financimit

1. AP-UPHP do të dorëzon specifikacionet teknike tek IWRM-K, për të mirat, shërbimet dhe punët sipas aktiviteteve në Shtojcën 1.
2. IWRM-K do të kryen të gjitha procedurat e nevojshme të prokurimit dhe pagesat korresponduese në mënyrë direkte kontraktorëve, në emër të AP-UPHP, siç parashihet me Shtojcën 1.
3. Pavarësisht se cila nga palët i kryen pagesat për nevoja të MP-IWRM-, nuk do të tejkalohet totali i buxhetit prej 150'000 Euro.
4. AP-UPHP dhe IWRM-K do të autorizojnë dhe verifikojnë së bashku përvetësimin e të gjitha punëve, të mirave dhe shërbimeve të dakorduara, ndërsa AP-UPHP do të udhëheqin mbikëqyrjen e punëve të ndërtimitarisë.

Neni 4: Kufizimet e përgjegjëse

Asnjëra Palë në këtë Letër Marrëveshjeje nuk do të jetë përgjegjëse për vonesat apo moskryerjen e ndonjë obligimi sipas kësaj marrëveshjeje, për shkak të rrethanave të natyrës, pandemisë, grevave ose pengesave të tjera, pa përjashtuar luftërat, aktet terroriste, kryengritjet, embargot, kufizimet qeveritare, veprimet e qeverive ose autoriteteve qeveritare, dhe çdo shkaktar tjetër jashtë kontrollit të Palëve.

Neni 5: Modifikimi

Nenet e kësaj Letër Marrëveshjeje mund të ndryshohen ose zëvendësohen me marrëveshje reciproke përmes korrespondencës me shkrim, me kusht që ndryshimet e tilla të mos ndikojnë në qëllimin kryesor të Letër Marrëveshjes dhe partneritetit midis AP-UPHP dhe IWRM-K.

Neni 6: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të paraqitet gjatë zbatimit apo interpretimit të kësaj Letër Marrëveshjeje, do të zgjidhet përmes konsultimit midis Palëve. Palët e kësaj Letër Marrëveshjeje do të përpiqen ta zgjidhin në mënyrë miqësore, me negociata të drejtpërdrejta dhe pajtim reciprok çdo mosmarrëveshje, apo ankesë në lidhje me interpretimin, zbatimin ose përmbushjen e dispozitave të kësaj marrëveshjeje. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje, nuk është paraparë të ndërmerret asnjë masë ligjore sipas këtij neni.

Neni 7: Hyrja në fuqi dhe ndërprerja

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Pala e fundit, si dhe do të mbetet në fuqi deri në fund të Fazës 1 të Programit IWRM-K (Prill 2024).
2. Bashkëpunimi i propozuar në këtë Letër Marrëveshjeje nuk është ekskluziv. Secila Palë mund ta ndërprejë Letër Marrëveshjen duke i dhënë një (1) muaj njoftim me shkrim Palës tjetër. Në rast të ndërprerjes, Palët do të ndërmarrin hapa për t'i kryer aktivitetet sipas Letër Marrëveshjes në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt.

Hartuar në dy dokumente origjinale, secili në gjuhët shqipe dhe angleze. Që të dy tekstet janë njësoj autentikë, por mbizotëron versioni në gjuhën angleze.

Për AP-UPHP:

Për IWRM-K:

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

Emri: Prof. Dr. Naser Sahiti
Pozita: Rektor i UP

Emri: Dr. Dimitrija Sekovski
Pozita: Udhëheqës i Ekipit të IWRM-K

Data:
Vendi: Prishtinë

Data:
Vendi: Prishtinë